

PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 18.01.2019, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Afrim Dina.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, LMT-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Ky është takimi i parë për vitin 2019, ju uroj të gjithëve suksese në punë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
3. Raporti vjetor i punë së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
4. Informatë mbi Planin e punës të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019,
5. Raporti vjetor financiar i komunës së Rahovecit për vitin 2018,
6. Informatë nga Plani vjetor i njësisë së auditimit të brendshëm të KK- Rahovec,
7. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Rekomandimeve për vitin 2018 nga auditori kombëtar (të jashtëm),
8. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2018,
9. Të ndryshme.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për këtë mbledhje e kemi një material voluminoz, dhe ne vetëm dy ditë kemi pasur mundësi që të lexojmë materialin sepse kopja fizike na ka ardhur shumë me vonesë, mendoj se nuk është mirë që kjo të bëhet praktikë edhe për mbledhjet e tjera, është mirë që të zbatohet afati ligjor prej 7 ditëve, në mënyrë që ne të kemi kohë për me u përgatit.

Kryesuesi – Po i nderuar është e vërtet se materiali në pjesën fizike është vonuar, sidomos Raporti Financiar për vitin 2018, por ne kemi pritur këtë raport që të na vije nga Ministria e Financave. Por besoj se materiali për mbledhjet e tjera do ju vije me kohë.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, edhe ne e ndajmë të njëjtin shqetësim si parafolësi, materiali na ka ardhur shumë me vonesë, kurse materiali është shumë voluminoz, nëse i marrim parasysh këto që i ceke kuptohet se koha nuk na ka mjaftuar mjaftë për ti analizuar të gjitha këto pika të rendit të ditës, për këtë arsye nuk pritet nga ne që të jemi shumë produktiv në këtë mbledhje, por ne do të mundohemi që të japim kontributin tonë. Besoj se për mbledhje të kuvendit

do të na vije materiali me kohë në mënyrë që ne të kemi kohë për të analizuar këto pika dhe të jemi produktiv në mbledhje.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të gjitha ato që u thanë nga parafolësit është e vërtetë, por ne e siç jeni duke parë e kemi respektuar Planin e punës së Kuvendit të cilin e kemi bërë bashkërisht, përndryshe këto dy raporte kanë mundur të shqyrtohen drejtpërsëdrejti në Mbledhje të Kuvendit, por ne kemi dashur që të respektohet edhe KPF-ja. Kurse sa i përket Raportit Financiar për vitin 2018, ardhja me vonesë e këtij raporti lidhet me vonesat nga ana e MF, pra ne kemi pritur që ata të na dërgojnë raportin në mënyrë që ne pastaj të ju dërgojmë juve. Po ju nëse jeni të pajtimit pasi ju kanë ardhur me vonesë këto dy raporte, por gjithmonë e ceku jo me fajin tonë, të i shqyrtojmë drejtpërsëdrejti në kuvend, tani të i kalojmë si pika.

Rasim Fazliu – E them pa kurrfarë tendence, por nuk është justifikim kjo që u tha sepse duhet të parashihet koha që materiali të na vije me kohë. Sa mi përket propozimit të Nënkryetarit që këto pika të shkojnë drejtpërsëdrejti në kuvend, unë nuk jam i pajtimit është mirë edhe sot të diskutojmë aq sa kemi mundësi, pra le të dalin drejtorët le ta prezantojnë.

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar

A ka dikush të shtojë diçka rreth procesverbalit, ndonjë vërejtje ose ndonjë sugjerim, nëse nuk ka atëherë e qes në votim Procesverbalin nga Mbledhja e Kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Shqyrtimi i Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, me datë 03.12.2018, anëtarja e KPF-së znj. Florije Boshnjaku e cila vinte nga radhët e AAK-së, ka dhënë dorëheqja dhe ne tani duhet që këtë vend ta plotësojmë me një anëtarë tjetër po ashtu nga radhët e AAK-së. Për këtë vend AAK-ja ka propozuar znj. Fjolla Duraku. E qes në votim Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Raporti vjetor i punë së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2018.

Nënkryetari – Ky është një Raporti i Punës së Kryetarit për vitin kalendarik 2018, është një raporte voluminoz, por nëse dëshironi ju unë mundem të prezantoj më gjerësisht, kjo varet nga ju se si e vlerësoni. Por në këtë raporte kryesisht janë të përfshirë përkushtimet, aktivitetet, punët dhe angazhimet brenda vitit 2018. Po ashtu janë të paraqitura synimet politike të qeverisjes, prioritetet, aktivitetet e ndryshëm që janë realizuar brenda viti 2018. Në pjesën e parë janë të përfshirë punët të cilët janë kryer nga zyra e Kryetari të Komunës, pastaj, nga zyra ligjore, njësia e auditimit të brendshëm, zyra për informim, zyra e prokurimit, pastaj zyra komunale për komunitete, njësia komunale për të drejtat e njeriut, njësia e personelit si dhe zyra për përfaqësimin ligjor. Pastaj në pjesën tjetër të raportit janë cekura punët e secilës drejtori për vitin 2018, po ashtu janë të paraqitura edhe punët e kryera në formë tabelare, nëse keni dëshirë unë mundem të hy edhe më gjerësisht, por në këtë raport nuk mundet të shtohet asgjë përpos asaj që është kryer. Ne jemi munduar sa më shumë ta shkurtojmë këtë raporte sepse përndryshe ky raport është shumë ma voluminoz dhe ka shumë ma shumë faqe, po ashtu Raportin Financiar e kemi ndarë nga Raporti i Punës së Kryetarit.

Rasim Fazliu - Fillimisht falënderoj Kryetarin e Komunës që na ka përgatitë këtë raport, dua të japë një vërejtje në fillim të raportit duhet të jetë Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018, sepse këtu vetëm ceket si Raport vjetor i punës. Në rendin e ditës është e cekur shumë mirë si Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018, kishte me qenë mirë që për mbledhje të Kuvendit ky titull të përmirësohet. Ky raport është goxha i thatë për arsye se nuk janë cekur saktësisht se cilat punë janë bërë nëpër secilën drejtori, por është shkruar në përgjithësi në disa çështje të caktuara, prandaj qoftë ne si kuvendarë qoftë edhe ndonjë lexues tjetër nëse dëshirojnë të njoftohen për punën e këtij raporti, në disa vende nuk mundet të i gjejnë disa të dhëna të mjaftueshme ashtu siç duhet. Nëse e marrim raportimin nga Njësia e Brendshme e Auditimit, aty shihet se janë të shkruara vetëm disa reshta, dhe nuk e di se si mundet të quhet ky raport nga kjo njësi, aty ceket se janë dhënë disa rekomandime, por është dashur të ceket se cilat janë ato rekomandime në mënyrë që ne të kemi të qartë. Nëse dalim tek Zyra e Prokurimit, edhe për këtë zyre janë të

cekura shumë pak të dhëna, këtu vetëm ceket se gjatë këtij viti janë anuluar 6 procedura të prokurimit për arsye të ndryshme, kurse edhe 3 procedura të tjera janë në shqyrtim, konsideroj se kjo nuk është e mjaftueshme dhe unë si kuvendar ose si qytetar i komunës së Rahovecit duhet të di saktësisht se çka ka ndodhë, pse janë anuluar, pastaj ku ka qenë defekti, pra thjeshtë ta di arsyen. Pastaj tek raporti i Zyrës së Personelit, ku ceken numri i punëtorëve të punësuar në administratën e Komunës së Rahovecit, është bërë një gabim teknik në mbledhjen e numrit të punëtorëve, sepse ceket se nga gjithsej 18 të emëruar politik femra janë 2 kurse meshkuj janë 12, kurse si stafe mbështetës janë emëruar edhe 2 femra dhe 3 meshkuj, pra këta punëtor nëse i mbledhim nuk përputhen me numrin 18. Sa i përket bursave gjatë mandatit të kaluar vetëm një herë janë dhen bursa, a është kjo e saktë sepse nuk e kam të qartë, këtu ceket se pas 3 viteve pauzë nga qeverisja e kaluar ne kemi arritur me i dhënë 63 bursa. Ajo që nuk e kam arritur unë është a janë tre vite apo më pak se tre vite, por ju sigurisht i keni të dhënat më të sakta, por gjithsesi unë e shohë si sukses që është arritur me ju dhënë bursa. Në faqe nr.22 tek tabelari me të hyrat nga taksat e afariste komunale, nuk jam duke kuptuar objektivin për vitin 2018 sepse gjithmonë shkruan 80,000.00 €, gjithashtu për vitin 2018 shuma është e cekur veçantë, dua ta di se çka është puna e këtyre 80,000.00 €, a është kjo diferenca e saktë sepse këtu i keni cekur diku në shtatë vende i keni cekur shumën prej 80,000.00 €, pastaj për vitin 2018 sa është shuma në fund është e cekur diferenca prej 803.00 €, dua të di kjo shuma e cekur prej 80,000.00 € a është e saktë. Në faqe nr. 24 sa i përket projekteve kapitale të Drejtorisë së Urbanizmit, ajo që më ka ardhur më interesante është lidhja e kontratës për krijimin e hapësirave të gjelbëruara dhe mbjellja e drunjtëve dekorativ, ajo që më ka lënë më së shumti përshtypje është se të gjitha fshatrat që janë përreth duke filluar nga fshatrat Zoqishtë, Opterushë, Brestocë, Hoçë e Vogel, Krushe e Madhe, pastaj Xërxë dhe Fortesë, kurse është anashkaluar fshati Celinë, pa dashtë me qenë lokalistë, por të ju them të drejtën më ka lënë përshtypje pse është anashkaluar pasi të gjitha fshatrat që e rrethojnë fshatin Celinë janë mbjellë drunjtë dekorativ. Por prapë unë jam shumë i kënaqur që janë mbjellë në ato fshatra por edhe në qytet dhe shpresoj se edhe në fshatin Celinë do i vije radha. Pastaj në faqe 25 ceket se gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe projektet në bazë të planifikimit të buxhetit për vitin 2018, janë hartuar projekte për drejtoritë e tjera komunale nga kompania projektuese e kontraktuar nga komuna e Rahovecit, por ajo që më ka lënë përshtypje është pse nuk është cekur emri i kompanisë projektuese në këtë raport, mendoj se është dashtë me cekë se cila kompani është për hartimin e projekteve, mendoj se është mirë që për mbledhje të kuvendit kjo kompani të ceket. Pastaj ceket se në bashkëpunim me drejtoritë e tjera janë identifikuar deponitë ilegale në Komunën e Rahovecit, pastaj janë realizuara aktivitete të përbashkëta me disa drejtoritë në pastrimin e deponive ilegale dhe aksione për pastrimin e ambientit, kishte me qenë mirë të ceket në mënyrë që ne të kemi më të qartë, cilat deponi janë pastruar. Kaq për momentin kontributin më të madh do e japim në mbledhje të Kuvendit.

Fehmi Cena - Të gjitha ato që i ceku z. Rasim Fazliu qëndrojnë, por unë vetëm di i kisha cekë disa çështje sa i përket këtij raporti, ky raport është mjaftë voluminoz prandaj mendoj se kishte me qenë më mirë nëse do të ishte prezantuar më shkurtë në mënyrë tabelare, për mua nuk ekziston pjesa që është planifikuar për këtë vit që jemi duke raportuar, por jemi duke parë vetëm pjesën që është realizuar. Në faqe nr.14 përmendet edhe proceduara e shpronësimit që është bërë për hapjen e rrugës për gjatë fabrikës së plastikës në Rahovec, kjo është një rrugë e re me duket që e lidhë rrugën tek komuna “Dëshmorët e Pashtrikut” dhe rrugën “Gëzim Hamza – Piktori”, mendoj se kjo rrugë duhet të hapet sepse do i lidhë dy rrugë ndër më kryesore të qytetit, sa e di kjo rrugë është në pronën e fabrikës së plastikës. Kjo është kërkesë e kahershme e qytetarëve të lagjes ku edhe unë banoj, dua ta di se deri ku kanë arritur procedurat për hapje të kësaj rruge, dua ta di në mënyrë që nëse ka nevojë të japim edhe ne kontribute rreth hapje të kësaj rruge. Sa mi përket sektorit të shëndetësisë në këtë raport janë cekur gjërat që janë bërë, kurse nuk janë të cekura gjërat që nuk janë realizuar, por për këtë do të diskutojmë më gjerësisht në mbledhje të kuvendit. Më kanë rënë në sy disa resorë në kuadër të komunës p.sh Zyra për Barazi Gjinore, ku i kanë cekur vetëm 3-4 reshta asgjë e shumë, edhe kjo rreth organizimit të ditës së 8 Marsit, por nuk shihet aji qëllimi kryesor i kësaj zyre, sepse mendoj se kjo zyre duhet më shumë të interesohet rreth barazisë gjinore, rreth pjesëmarrjes së barazisë gjinore në të gjitha strukturat, duke përfshirë edhe strukturat e vendimmarrjes, e jo të na ceken datat e caktuar që janë për gjininë femërore sepse këto munden të organizohen edhe pa pasur zyre për barazi gjinore. Tek faqe me nr. 31 sa i përket subvencioneve, këtu ceket numri i hektarëve që janë subvencionuar në përgjithësi, por mendoj se është dashur të ceket p.sh sa hektarë janë subvencionuar në vreshtari, pastaj sa ka qenë buxheti i subvencionimit, pastaj subvencionimi në

grurë, po ashtu edhe këtu të ceket buxheti. Në këtë mënyrë ne si kuvendarë do të kishim ditur se sa ka përfituar komuna jonë nga subvencionet nga secili resorë. Në faqe nr. 35 ku bëhet fjalë për inspektorët e ndërtimit, jam duke parë që ata paskan pasur nën mbikëqyrje edhe vendosjen e ormanëve të rrjetit nga ana e KEDSIT, lagja në të cilën unë banojë është njëra ndër lagjet që Keds i ka vendosur kabllot nën tokë, kjo është për tu përshëndetur sepse është një projekt i qëlluar, por ormanët që janë vendosur nga ana e tyre nuk është se janë vendosur me ndonjë rregull ose plan, disa janë vendosur horizontalisht rrugës disa vertikalisht, mendoj se janë bërë goxha pengesë për trotuare dhe këmbësorë. Nuk e kundërshtoj vendosjen e ormanëve por vendosja e tyre nuk është bërë me plan, mendoj se është dashur të bisedohet me qytetarët e secilës lagje në mënyrë që të gjendet një zgjidhje më e mirë. Sa i përket bursave nuk e paskam ditë që 3 vitet e kaluara nuk kanë përfituar bursa studentët, unë si qytetarë i Rahovecit kam menduar se bursat janë ndarë çdo vit nga ana e komunës, e përshëndes ekzekutivin që i ka ndarë në këtë vite bursat për student, jam i mendimit se bursat për student duhet të ketë çdo vit,, por shpresoj se shpërndarja e bursave të jetë racionale ashtu siç është nevoja. Kjo ishte e gjitha, besoj se për mbledhje të kuvendit do të jemi më produktiv në analizën e këtij raporti.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, janë dy arsye që sot nuk jam shumë efektivë, njëra nga arsyet e cekun edhe kolegët parafolës sa i përket materialit i cili është duke na ardhur me vonesë, më lehtë e kisha lexuar romanin “Lufta dhe Paqja” dhe në fund e kisha dhënë një përfundim se sa këtë material me kaq kohë të shkurtër që e kemi pasur, mendoj se është mirë të jeni më ekspeditiv dhe të shkruani më pak por të jenë të përfshira gjërat më përmbajtësore. Do të diskutoj shkurtimisht e jo fletë për fletë, sa i përket shëndetësisë a kemi material të mjaftueshëm për pacientë që vinë të kërkojnë ndihmë, ne jemi duke ndërtuar një emergjencë kurse në anën tjetër nuk kemi reagens të analizave, kam qenë disa herë dhe nuk kanë pasur. Të nderuar nëse një shtëpi e shëndetit nuk ka reagens çka mundet të thuhet më tutje për gjërat tjera, prandaj mendoj se ne jemi nduke shkuar më shumë në formë se sa në përmbajtje, pastaj është mirë që të aktivizohen edhe ambulantët që janë të pa aktivizuara, po ashtu të furnizohet të gjitha ambulantët me material sepse qytetarët sepse qytetarët janë duke u ankuar se nuk janë duke i mare shërbimet ashtu si duhet. Sa i përket DKA-së ajo që më intereson është kontrollimi sistematik që ju është bërë fëmijëve në shkolla, sepse ishte e cekur kjo tek DSHMS-ja, mua më intereson ta di se cili është numri i kontrollimeve sistematike që i keni bërë nëpër shkolla, unë për vete nuk kam dëgjuar se është bërë ky kontrollim, mendoj se duhet të bëhet sepse për shkak të një sëmundje të lehtë mundet të transmetohet tek të gjithë të tjerët dhe nëse nuk i rimë ne gati atëherë mundet të vije edhe tek pasojat më të rënda. Kur jemi tek shkollat e njëjta gjë vlen edhe për Drejtorin e Kulturës sa i kemi furnizuar ne shkollat me laboratorë, cila shkollë ka laboratorë funksionalë që nxënësit së bashku me mësuesit me i shpreh ato mësimet që i mësojnë. Kur jemi tek shkollat është mirë që mos të vrapojmë gjithmonë për të ngritur objektet e reja kurse mësimi të mbete mbrapa për shkak të këtyre dobësive të cilat janë për çdo ditë të pranishme. Pastaj më intereson ta di se cili është numri i librave që i keni furnizuar shtëpitë e kulturës, dhe cili është aktiviteti i jonë si komunë për furnizim të këtyre institucioneve me tituj të ri të librave, ne nuk jemi duke i furnizuar as shkollat me libra por as bibliotekat. Ne e dimë që nxënësit dëshirojnë të kenë aktivitete të lira, kurse ne në shkolla nuk kemi asnjë aktivitet të lirë kulturorë, nuk kemi grupe folklorike, të poeteve etj. më parë këto aktivitete janë zhvilluar dhe po ashtu ka pasur edhe gazetë e tyre, kjo është ajo që ndikon tek nxënësit që të rritet kualiteti i mësimi dhe në këtë mënyrë do të forcohet trekëndëshi nxënës-prind-mësimdhënës.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të ndërlihdesh pak tek kjo pabarazi gjinore sepse barazi gjinore absolutë nuk mundemi me thanë, numri i punëtorëve në Komunën e Rahovecit gjithsej është 162 nga ata 28 janë të gjinisë femërore. Kurse tani gjithsej janë 18 të emëruar politik në poste drejtuese nga ta gjithsej femra janë 2 kurse meshkuj janë 12, është po ajo që e përmendi parafolësi paraprakisht, mendoj se kjo duhet të merret pak më seriozisht sepse edhe ju e keni përmendur brenda raportit se në komunën tonë ende mbetet sfida barazia gjinore. Do të ndërlihdem pak edhe sa i përket DKA-së, është përmendur në raporte përmirësimi i infrastrukturës si ajo e jashtme ashtu edhe ajo e brendshme në institucionet edukativo arsimore, mendoj se do të ishte e mirë dhe e rrugës të na ishte cekur saktësisht për secilën shkollë se çka është bërë, pastaj a janë pajisur këto shkolla me pajisje laboratorike, pastaj me teknologji informative etj. pastaj është përmendur edhe zvogëlimi i mungesave të paarsyeshme deri në minimum i nxënësve dhe mësimdhënësve, është mirë të ceket në cilat shkolla është bërë saktësisht. Pastaj DKA-j ka kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të ndalojë procedurat e prokurimit për thëngjill si lëndë djegëse,

dua ta di se cila është arsyeja, gjatë muajit tetor dhe deri para fillimit të sezonit dimërorë të ngrohjes me 15 nëntor 2018, në të gjitha shkollat është bërë furnizimi me dru dhe lëndë tjera djegëse për ngrohje. Të nderuar dua ta di se cilat janë ato lëndë tjera djegëse pos druve që janë duke u përdorur në shkolla. pastaj keni cekur se është bërë zgjerimi i stafit të DKA-së me kuadër të pedagogëve dhe psikologëve, kur do të filloj kjo dhe në cilat shkolla sepse ky është raporte i vitit 2018 prandaj mendoj se është e drejtë të i kërkojmë këtë sqarime. Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara në vitin 2018, në cilin lokalitet saktësisht është ndërtuar një shkollë, ose në cilin lokalitet është rinovuar një shkollë, kishte me qenë mirë të ceket, këto janë gjërat të cilat më bëjnë përshtypja më shumë se çdo gjë tjetër. E keni cekur se është përfunduar një segment rrugor në Malësi të Vogël, dua ta di se cili është ai segment saktësisht, pastaj ka filluar të trajtohet me kujdes ndërtimi i disa trotuareve që janë prioritet i lartë si në rrugën kryesore në Rahovec, Drenoc, Fortesë, Malësi të Vogël e shumë vendbanime të tjera, përsëri po e ceki ku saktësisht, prioritet e keni vendosur edhe rrjetin e kanalizimeve,, kurse ne kemi dëgjuar vetëm për dy të tilla. Kanali i kullimit të tokave bujqësore në fshatrat Ratkoc, Malësi e Vogël dhe Gexhë i cili ka qenë i harruar qe katër vite ka filluar të implementohet tani, kur ka filluar saktësisht sepse unë personalisht nuk kam dëgjuar që kanë filluar punimet.

Nënkryetari – Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë, të ju them të drejtën Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018 i ka mbi 60 faqe, ne jemi munduar që ta shkurtuajmë raportin dhe jemi munduar që në detaje ato gjërat kryesore të i përfshimë për çdo drejtori, për çdo rrugë, për çdo kanalizim, në cilin vendbanim dhe në cilën rrugë do të ndërtohet, nëse jeni të interesuar ne mundemi të gjitha me i përfshi, ne i kemi të gjitha të dhënat. Ideja jonë ka qenë që ky raport të jetë ma i shkurtër, përndryshe siç e thash raporti është mbi 60 faqe. Kurse sa i përket punëve që nuk janë kryer në vitin 2018 i nderuari z. Fehmi Cena, do të parashihen të kryhen me Planin e punës të viti 2019, po ashtu edhe ato kontrata që janë 2 ose 3 vjeçare. sa i përket vendosje së ormanëve nga ana e Kedsit, pajtohem plotësisht me atë që e tha z. Fehmi Cena, por i nderuar të dilni ju me ne në teren dhe të shihni se çfarë ankesa kanë qytetarët çuditëni, për 20 cm e shtynë jo andej jo këndeje, besoni se është bukur shqetësuese dhe bukur problem me i ra tamam të gjithëve. Ne kemi dëshirë që të i eliminojmë telat e rrymës që janë në shtylla dhe të i vendosim në tokë, por nuk lejojmë as gjysma metri të na pengoj ai orman, por ne jemi munduar edhe me inspektoratin po ashtu edhe me Drejtorin e Shërbimeve Publike që të i rregullojmë sa ma mirë këto punë. Sa i përket bursave është e vërtet që ka pasur pauzë prej 3 viteve, në atë kohë bursat janë ndarë nga subvencionet e kryetarit të Komunës, dhe për arsye të mungesës së buxhetit nga subvencionet ish kryetari i komunës nuk i ka ndarë bursat, sepse mjetet e subvencioneve të Kryetarit të Komunës kanë shkuar në shërbime të varrimit, por mendoj se ish kryetari i komunës ka pasur mundësi që ti merë mjetet nga kodi Mallrave dhe Shërbimeve në mënyrë që mos me mbete pa bursa studentët. Por ne pas një pauze 3 vjeçare i kemi ndarë 63 bursa për studentë. Kurse tek vizitat sistematike ne e kemi pas një raport që na ka sjellë Drejtoria e Shëndetësisë në kuvend para disa kohe, aty është cekë sakta se në cilat shkollë kanë qenë mjekët për vizitë sistematike, pastaj aty është cekë se sa nxënës kanë qen me grip, sa me sëmundje kronike dhe me disa sëmundje që nuk duhet ndoshta me i cekë. Sa i përket barazisë gjinore që e përmendi znj. Fahrije Lushi, te punësuar femra tek stafi politik dua të ndërlihem, mandatin e kaluar Kryetari aktual z. Smajl Latifi i patë emëruar dy femra në pozita udhëheqëse, kurse edhe tani në këtë mandat i ka emëruar 2 femra, përderisa të tjerët që kanë qeverisur me komunën nuk kanë pasur asnjë femre në pozitë udhëheqëse.

Artan Asllani - Përsëritje për të gjithë të pranishmit, do i përgjigjem pyetjes që e bëri z. Rasim Fazliu tek tabelat e të hyrave të taksës komunale, ne e kemi bërë një formë tabelare që e përcakton për muaj dhe vitet, por objektivi është për të gjithë vitin 2018, i cili është në shumën prej 80,000.00 €, objektivin nuk e cakton Drejtoria e Ekonomisë, por Drejtoria e Financave. Po ashtu ne e kemi cekur edhe për periudha mujore, pra sa është paguar muaj për muaj, pastaj komplet dallimi për komplet vitin që i bie në këtë rast është në shumën prej 38,963.00 € më shumë se në periudhën e viti të kaluar.

Avni Morina – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, në raporte ne si DKA jemi munduar që të i përfshimë të gjitha aktivitetet që i kemi pasur nga muaji janar e deri në muajin dhjetor, por e kemi vërejtur se disa nga këshilltarët komunal i kanë ngatërruar aktivitetet m objektivat tona të përhershme që i kemi, prandaj ato që janë të përhershme vlejné edhe për vitet e ardhshme e jo vetëm për këtë vit. E nderuara znj. Fahrije Lushi pyeti se ku janë ndërtuar ato shkolla, e nderuar ne ja kemi filluar me ndërtim të shkollave, nuk kemi mundur me i krye sepse është viti i parë i qeverisjes, pastaj e nderuar objektivat janë të përhershme, ju nuk e keni

lexuar aktivitetet e drejtorisë. Vizitat sistematike janë organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me DKA-në. Z. Dervish Çadraku nuk kam qare pa e bërë shok në Facebook, kur e thotë ai që nuk ka aktivitete nëpër shkolla si shoqëri kulturore, grupe letrare etj, i nderuar mendoj se asnjëherë nuk ka pasur më shumë se tani, por prapë ai është mendim i juaji dhe e respektoj. Është e vërtetë të nderuar se pas tre viteve pauzë bursat për student janë ndarë këtë vit, tre vitet e kaluara nuk ka pasur bursa për studentë. Ne kemi kontratë dy vjeçare me operatorin Isa Dekor për riparim të objekteve shkollore, kjo kompani nuk i ka kryer punët ashtu siç është dashur të i kryej ose si i ka pasur në kontratë, por kjo kompani kontratën e ka deri në muajin korrik 2019. Pastaj përveç druve si lëndë djegëse në shkolla përdoret nafta dhe peleti, vetëm thëngjilli është i ndaluar nga Ministria e Arsimit, kurse ne si komunë e kemi zbatuar vendimin e ministrisë.

Fahrije Lushi Morina – desha ta falënderoj Drejtorin e DKA-së për sqarimet që na i dha, por i nderuar unë kam lexuar pos objektivave edhe synimet kryesore që i ka Drejtoria e DKA-së, arsyeja është se më shumë se në këtë drejtori askund nuk e shohë veten. Qëllimet kryesore ishin përmirësimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo arsimore, pastaj tek aktivitetet e juaja të realizuara ishte heqja e thëngjillit si lëndë djegëse. Andaj me konsideratë e them që herrave të tjera përgjigjet të i jepni edhe qoftë në formë kritike por në një formë pak më modeste.

Dervish Çadraku – I nderuar Drejtor Facebooku është aktivitet i lirë nuk është i domosdoshëm dhe komunikimet bëhen kështu si sot, prandaj nuk mundem të lidhem unë me atë se çka shkruan ti në facebook ose çka shkruaj unë, pastaj nuk mu përgjigje se cilët janë investimet e juaja për furnizim të shkollave me libra, pastaj kabinetet e shkollave a i keni furnizuar me teknologji informative.

Avni Morina – Unë thjeshtë e përdora për shaka Facebookun, por mendoj se jemi të vetëdijshëm se edhe liderët më të mëdhenj botëror e përdorin këtë rrjet social ku i japin informacionet e tyre, është njëra prej pasqyrave të aktiviteteve që i zhvillojnë shoqëritë në përgjithësi. Sa i përket pajisjes së shkollave me mjete të konkretizimit si laborator ose libra, ne gjatë viti të kaluar nuk kemi pas kontratë të trashëguar, e di se çfarë gjendje është nëpër shkolla, por janë gjithsej 7 shkolla të komunës sonë që ju janë nderuar dyert, këtë nuk e di a e dinë znj. Fahrije Lushi, por në raport të nderuar nuk kam mundur të gjitha të i përfshi me emra, por këto janë gjërat që kanë ndodhur.

Kryesuesi – Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë rreth kësaj pike. Kalojmë tani në pikën e radhës:

4. Informatë mbi Planin e punës të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019.

Nënkryetari – Meqenëse këto janë materiale voluminoze nuk do të zgjasë shumë, në mënyrë që fjala të jetë e juaja, por unë do e lexoj disa të dhëna nga Plani Qeverisës për vitin 2019. Në këtë plan janë cekur disa synime ku janë cekur përmbyllja e ciklit të investimeve në ujësjellës, pastaj trajtimi i ujërave të zeza, në bujqësi, në rrugë fushore, pastaj në shërbime shëndetësore të ritet efikasiteti, nxitja e zhvillimit të turizmit, shtimi i hapësirave të gjelbëruara, pastaj investime sa më shumë në arsim kulturë rini dhe sport, ndërtimi i çerdheve për fëmijë, mbrojtja sistematike e mjedisit dhe shumë gjera të tjera. Po ashtu i kemi cekur disa plane të veprimit se si të i ruajmë të hyrat komunale, inkasomi i të hyrave në tokë, planet e veprimit si të kuvendit komunal ashtu edhe të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Planit të anti Korrupsionit, prokurimit, auditimit etj. po ashtu në këtë plan janë të cekur edhe prioritetet e tjera por mos ta zgjas më shumë sepse i keni të gjitha në materialin që ju kemi dërguar si me postë ashtu edhe me email.

Rasim Fazliu – E falënderoj Kryetarin që na ka sjellë këtë Plan të punës për vitin 2019, por e thash edhe më parë por po e them edhe tani ajo që nuk më pëlqen edhe në këtë Plan është se jemi shumë abstrakt. Po ja filloj nga Drejtoria për Shërbime Publike, e kuptoj se nuk ka mundësi që ti i cekë të gjitha ato që do të kryhen në vitin 2019 në detaje, por meqenëse ne kemi një buxhet të gatshëm për vitin 2019 dhe në bazë të këtij buxheti ne e dimë se çka mundemi me krye, sepse mendoj se gjithmonë plani duhet të jetë i përafërt. Po e cek një pikë ku thotë: Ndërtimi i rrugëve në fshatra dhe qytete sipas prioritetëve, meqenëse e kemi buxhetin dhe e dimë saktësisht sa është, prandaj mendoj se do të ishte mirë që të jeni më konkret, pra të ceken se sa kilometra rrugë do të shtrohen brenda këtij buxheti të vitit 2019. Pastaj përsëri ceket: Ndërtimi i trotuareve në Komunën e Rahovecit sipas prioritetëve, përsëri edhe kjo është shumë abstrakte, pra asgjë nuk është konkrete, mendoj se planifikimi duhet të jetë më konkret, kjo që e thashë vlen për të gjitha drejtoritë e tjera.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket atyre dy çështjeve që u ngritën nga parafolësi në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i nderuar është e vërtetë ajo që e thatë, por këtë vite do të ketë disa ndryshime sa i përket udhëzimeve administrative që do të dalin nga niveli qendrorë. Në bazë të

planifikimit që do të bëhet p.sh precizohet se sa mjete financiare që i ke aq duhet edhe të planifikosh projekte, por kur ka kontrata dy vjeçare ose më shumë se dy vjeçare, atëherë insistohet në bazë të kërkesave të qytetarëve që vinë dhe ne pastaj tentojmë që të planifikojmë pak ma shumë si trotuare ashtu edhe rrugë. Por ne në regjistra i kemi të gjitha kërkesat që na kanë vinë nga Këshillat e fshatrave si në debate publike,, si dhe gjatë vitit që na kanë ardhur. Në mbledhjen e kuvendit nëse dëshironi unë mundem me i cekë se sa kërkesa janë adresuar për rrugë, sa për trotuare, për shenjëzime dhe kërkesat e tjera, po ashtu përafërsisht mundem të ju tregoj se sa kilometra rrugë do të shtrohen, ose sa kilometra kanalizim do të ndërtojmë.

Dervish Çadraku – Në Drejtorin e Administratës së Përgjithshme e kemi sektorin për të drejtat e njeriut, mu amë intereson ta di se çfarë pune kryen kjo njësi. Ideja është që ti ofrojmë qytetarëve shërbime sa më afër dhe sa më të shpejta, pyetje ime është: Ku mbeten njerëzit me aftësi të kufizuar ose aftësi të veçantë, në këtë njësi asnjë nuk e kemi të punësuar, kurse kjo njësi as që e ngritë zërin që të bëhet diçka në këtë drejtim. Pastaj kjo kategori nuk kanë mundësi që të qasen në zyrat e komunës, sepse nuk ka lift, është folur se do të bëhet një lift por ende nuk ka ndodhur kjo. Mendoj se kjo njësi duhet të i shikojë këto punë sepse për atë janë të punësuar e sidomos kur bëhen shkelje të të drejtave të njeriut.

Fehmi Cena – Ky plan është mjaftë voluminoz dhe gjithëpërfshirës, ku janë të përfshirë të gjitha drejtoritë. Do të ndalem pak tek Drejtoria për Shëndetësi sepse është fjala për planifikim për vitin e ardhshëm, pasi jam i atij profesioni gjithashtu aty punoj, mendoj se i njohë gjërat aty si shkojnë. Tek planifikim për vitin e ardhshëm ka disa mungesa që do të duheshin të përfshihen, nuk jam duke parë askund tek planifikimi Implementimi i mjekësisë familjare, edhe pse ka vit që ne jemi duke thënë se do të implementojmë, por komuna jonë është shumë mbrapa sa i përket kësaj, mendoj se ky duhet të jetë synimi i përditshëm deri sa të realizohet në tërësi. Për të implementuar mjekësin familjare të nderuar neve na duhen më shumë mjekë familjarë, pyetje ime është a ka komuna ndonjë plan se si me e realizue këtë sepse pa mjekë familjar nuk mundet të realizohet mjekësia familjare, nëse nuk realizohet kjo atëherë ne vazhdimisht kemi me qenë mbrapa dhe nuk mundemi të lavdërohem se i kemi punët mirë në shëndetësi. Nuk jam duke e parë në këtë plan Sistemin e Informimit Shëndetësorë në formë elektronike, e kemi cekë edhe më parë këtë, ky sistem ka filluar në vitin 2017me u realizue, Rahoveci ka qenë në Pilot Projektin së bashku me 12 komuna në nivel të republikës së Kosovës, kam qenë në një komision në nivel të ministrisë, ne si QKMF sa patëm filluar që të hymë në formën elektronike e cila ngërthen në vete shumë anë pozitive, për arsye se e kemi regjistrimin e pacienteve, pastaj krijon një rregull shumë të mirë të punës ku kjo rregull pastaj ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, pastaj kemi të hyra më shumë etj. por kur ka filluar që të ndërtohet objekti i ri i QKMF-së ky projekt është ndërprerë sepse diçka është prishur, dhe që nga ajo kohë me këtë projekt askush nuk është duke u marrë, mendoj se dikush duhet të merret me këtë që ta rregulloj këtë sistem të kontrollimit elektronik. Është përmendur më parë ndërtimi i shtëpisë së pleqve për qëndrim ditor, këtë e kemi aprovuar në kuvend në kur ka qenë si pikë Korniza afatmesme buxhetore, mendoj se këtu pastaj duhet të kyçet personeli shëndetësor për mbikëqyrje të këtyre pleqve, prandaj mendoj se kjo e ka vendin në shëndetësi por nuk jam duke e parë këtu në këtë raport. Ajo që nuk jam duke parë gjithashtu është zgjerimi i shërbimeve shëndetësore, e kam përmendur edhe më parë komisionin për certifikata dhe patentë shofer, qytetarët vinë çdo ditë tek ne të pyesin,. Ne ju themi se Rahoveci nuk ka komisionin mjekësor për ti dhënë këto certifikata, pastaj banorët tanë janë të detyruar të shkojnë nëpër komuna të tjera, pra ne jemi duke humbur në të dy anë, njëra anë mos inkasomë dhe në anën tjetër qytetarët tanë janë të detyruar të shkojnë në komunat e tjera, është mirë që edhe kjo të futet si pjesë e zgjerimit të shërbimeve në Drejtorin e Shëndetësisë. Nuk jam duke parë askund ambulancën e mjekësisë familjare në fshatin Zoqishtë, në vitin 2017 më duket se ka filluar të punojë,, kjo ka zgjatë disa muaj, pastaj përsëri është mbyllur, e kuptoj që nuk ka mjekë të mjaftueshëm por duhet të jetë një arsyetim sepse ajo është master plan. Qytetarët neve për çdo ditë na pyesin si kuvendar që jemi pse nuk është duke u rihapur, pastaj na kërkojnë që të ndikojmë që të rihapet kjo AMF, nëse keni arsyeshmeri kishte me qenë mirë që ta cekni se cila është arsyeja që nuk po hapet. Tek arsimi gjithashtu ceket se është synim për këtë vit që të inkadrohet kuadri i pedagogëve dhe psikologëve, e përshëndes këtë iniciativë dhe shpresoj se me të vërtet kjo të bëhet e mos të mbetet vetëm në letër, sepse angazhimi i tyre nëpër shkolla tona si ato fillore ashtu edhe ato të mesme është më se e domosdoshme duke e ditë se në çfarë kohe ne jemi duke kaluar, dhe përfshirja e tyre do të jepe një kontribute të madh karshi shumë çështjeve.

Florida Bajraktari – Tek Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si prioritet ceket ofrimi i shërbimeve në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët, mendoj se vitin e kaluar nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët, pasi që vetë personalisht kam qenë në QKMF ku kam pasur një kontroll tek mjeku, ku pas kontrollit nga ana e mjekut kam shkuar tek dhoma ku jepen injeksionet dhe njëra nga infermierët më tha nuk ka asgjë duhesh që ti blesh të gjitha, kurse në atë moment një infermiere tjetër të cilën e njisha më tha nuk ka nevojë se ka këtu në dollap. Mendoj se pasi është ky planifikim për vitin e ardhshëm kishte me qenë mirë që të shikohen këto gjëra sepse shumica nuk i kanë kushtet që ti blenë ilaçet.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Raporti vjetor financiar i komunës së Rahovecit për vitin 2018.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtori Limani prezantoi para anëtareve të KPF-së Raportin Financiar për vitin 2018 ku i ceku gjërat kryesore të këtij raporti. Ky raport konsideroj se është një raport shumëdimensional, ku janë të përfshirë të gjitha ngjarjet dhe aktivitete financiare të komunës së Rahovecit përgjatë vitit 2018. Ky raport është i përbërë nga tri pjesë kryesore: Pjesa e të hyrave, shpenzimeve dhe të gjitha aktivitete që janë bërë në zyrën e prokurimit. Të hyrat totale për vitin 2018 kanë qenë 994,848,00 €, krahasim me vitin 2017 kemi një ndryshim pozitiv prej 173,982.00 €. Kurse të hyrat nga gjjobat e gjykatave dhe gjjobat e trafikut kanë qenë: gjjobat e gjykatave për vitin 2018 kanë qenë 129,797.00 €, ku kemi një ndryshim pozitiv prej nga viti 2017 në shumën prej 52,399,00 €, në këto të hyra ne nuk kemi qasje, pra nuk mundemi të ndikojmë asgjë. Kurse gjjobat e trafikut për vitin 2018 kanë qenë 126,149.00 €, edhe këtu kemi një ndryshim pozitiv nga viti 2017 në shumën prej 85,316.00 €. Nëse i marrim të hyrat e rregullta së bashki me gjjobat e gjykatave dhe gjjobat e trafikut, na dele që komuna e Rahovecit për vitin 2018 ka pasur një realizim prej 1,150,794.00 €, nëse e bëjmë një krahasim me vitin 2017, na dele se kemi një ndryshim pozitiv prej 211,641.00 €. Sa i përket shpenzimit të buxhetit kemi të paraqitur shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe sipas programeve, prej pagave dhe mëditjeve e deri tek kapitalet, si dhe nga zyra e kryetarit e deri tek arsimit i mesëm, këtu janë të përfshira edhe të hyrat vetanake, të hyrat e bartura, donacionet dhe huamarrjet. Kurse në faqe nr.9 e kemi të paraqitur dhe shpenzimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike në raport me buxhetin e planifikuar dhe të alokuar. Shpenzimi i buxhetit të Komunës së Rahovecit në raport me buxhetin e planifikuar në të gjitha kategoritë është në masën prej 95.38%. kurse shpenzimi i buxhetit në raport me alokimin është në masën prej 97.65%. në faqe nr.16 i kemi të paraqitura të gjitha aktivitete e zyrës së prokurimit, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, vlera e buxhetit etj. Borxhet financiare që Komuna e Rahovecit i ka krijuar janë: Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 118,354.00 €, në raport me vitin e kaluar kemi arritur që këtë kategori ta zvogëlojmë në shumën prej 53,000.00 €, komunalit i kemi 592.00 €, në subvencione 720.00 €, kurse në investime kapitale i kemi 1,272,236.00 €. Nëse i krahasojmë me vitin e kaluar do të shohim se kemi arritur një zvogëlim të borxhit prej 1,47,000.00 €.

Kryesuesi – Para se të ja japë fjalën dikujt prej anëtarëve të KPF-së desha të ju pyes diçka rreth këtij raporti. Në faqe nr.10 tek mallrat dhe shërbimet sipas programeve, kishte me qenë mirë që për mbledhje të kuvendi ta shtoni edhe një shtyllë tek pjesa e shpenzimeve të asamblesë, është mirë që të sqaroni sepse këtu janë të cekura disa shpenzime që ne nuk i kemi bërë ne si asamble.

Rasim Fazliu – Fillimisht e falënderoj Drejtorin e Financave që na ka sjellë këtë raport përmbajtësor, po ashtu ai vetë e tha se ajo që mungon do e plotësoj për mbledhje të kuvendit. Këtu janë gjërat që shihen dhe shifrat flasin vetë. Mirë është bërë që të hyrat vetanake janë rritur këtë vit në dallim nga vitet paraprake, kjo është mirë sepse shkon drejtpërsëdrejti në të mirën e qytetarëve, edhe pse planifikimi ka qenë shumë i madh. Tek krahasimi i të hyrave nga gjjobat e trafikut dhe gjjobat e gjykatave, në gjjobat e trafikut kemi ngritje për 52,332.50 €, kurse tek gjjobat e gjykatave ka rrënjë sigurt se nuk kanë mundur të realizojnë ata në gjykatë. Tek planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë, edhe këtu kemi rritje dhe kjo është shumë mirë që ka ndodhë. Tek shpenzimet sipas kategorive ekonomike sipas paraqitjes grafike që e ka bërë drejtori. Nëse marrim në total realizimin e buxhetit për vitin 2018, duhet të jemi të kënaqur me realizimin, por mendoj se ka pasur vend që, p.sh tek subvencionet të realizohet edhe më tepër, në bazë të alokimit kjo që ka ndodhur 92.56 %, kurse në bazë të buxhetit të planifikuar ka qenë 89.97 %, këtu ka mundur të ketë rritje duke u bazuar në faqen e fundit ku jemi duke parë që kemi obligime financiare, pra nëse do të ishin realizuar më tepër në anën tjetër ishin zvogëluar obligimet financiare. Pastaj tek shpenzimet kapitale siç e ceku edhe drejtori që në bazë të alokimit është 94.72%, edhe këtu mendoj se është dashur të jetë alokimi më i madh për arsye se në investime kapitale

obligimet financiare janë 1,272,236.76 €. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve sipas programeve të paraqitura në këtë raport, kemi ngritje të shpenzimeve në mallra dhe shërbime karshi viti 2017, ku diferenca është për 74,900.00 € më shumë këtë vit, por unë e kuptoj këto shpenzime sepse në këtë vit në këtë kategori janë futur edhe shpenzimet e varrimit. Kaq për këtë mbledhje, më shumë do të japim kontribut në mbledhje të kuvendit.

Florida Bajraktari – Tek krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike 2017/2018, tek kodi i taksës për ushtrimin e veprimtarisë është e cekur një shumë më e madhe në krahasim me vitin 2017, dua ta di si se çka ka ndikuar që është arritur një realizim kaq i madh në vitin 2018. Pastaj tek kodi i mallrave dhe shërbimeve tek kodi i karburant për vetura për asamblenë përsëri ka një rritje të madhe në krahasim me vitin 2017, pse është bërë tek asambleja kur ne nuk e shpenzojmë veturat e komunës për asamble. Tek kodi i mirëmbajtjes së ndërtesave është e cekur përsëri një shumë e shpenzuar tek asambleja, a ka asambleja ndërtesa por ndoshta kemi e ne nuk e dimë.

Fehmi Cena – Sa i përket raportit është një raporte gjithëpërfshirës, shumë i qartë i prezantuar mirë në mënyra tabelare, sidomos pjesa krahasuese me vitin paraprak na jepe një pasqyrë të sakët që ne të shikojmë se si ka rrjedh çështja e financave si në të hyra ashtu edhe në shpenzime. Siç jam duke e par kemi një rritje sa i përket të hyrave dhe kjo është për tu përshëndetur. Kurse në raport me planifikimin është mjaftë për tu dëshiruar, nuk dua të hy në detale, por i kemi ne disa vërejtje sidomos tek shpenzimet dhe mallrat, mendoj se kjo është ajo pjesa ku komuna mundet me kursye dhe të shpenzoj sa më pak. Kisha kërkuar një sqarim nga drejtori, tek faqe nr. 8 tek programet tek pjesa e huamarrjes, p.sh tek shëndetësia kemi huamarrje në shumën prej 18,485.00 €, pastaj arsimi ka pasur huamarrje më shumë se 7,000.00 €, pyetja ime është a i keni mare nga shëndetësia dhe ja këndi bartë dikujt tjetër apo anasjelltas.

Afrim Limani - Ju faleminderit të gjithëve për komplimentet e bërë sa i përket raportit dhe pyetjet e parashtruara, mendoj se ky nuk është vetëm sukses i yni, por është sukses edhe i juaji dhe gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit. Tek pjesa e shpenzimit të buxhetit është e vërtet se është një rritje e shpenzimeve, por ne kemi arritur që në kategorinë për mallra dhe shërbime borxhet e viti 2017 të shlyejmë të gjitha, kurse edhe ne tani kemi krijuar shpenzime zakonisht për muajin nëntor dhe dhjetor sepse siç e dimë të gjithë në këto muaj mbyllet viti fiskal dhe pastaj nuk kemi mundësi me i fshi faturat e mbetura. Kurse tek pjesa të hyrave tek kategoria e gjobave dhe gjykatave, siç ju thash edhe më parë këto janë të hyrat të cilat ne si komunë nuk kemi qasje, të gjitha këto varen nga dikush tjetër, e mira e kësaj është se këtë vite kemi pasur të hyrat nga gjobat e trafikut, por tek gjobat e gjykatave kemi një rrënjë të vogël, por dhe më ka ardhur 3 mujori i fundi i cili nuk është i përfshirë në këtë raport, shihet se është një ndryshim i vogël pozitiv. E nderuara znj. Florida ajo që ka ndikuar në rritjen e taksës afariste është angazhimi dhe përkushtimi më i madh në punë, pra nuk kanë lëshuar vërtetim pa paguar taksën, pastaj Drejtoria për Ekonomi ka mare disa veprime shumë të duhura, ku ka shpërndarë vërejtje me kohë dhe prandaj është arritur kjo rritje. Kurse sa i përket mirëmbajtjes së ndërtesave që e thatë se janë të përfshirë në kodin e asamblesë, e nderuar në kuadër të këtij buxheti jemi të gjithë, po ashtu edhe kuvendi ka bërë shpenzime të karburantit sepse edhe ju ndonjëherë keni bërë lëvizje që të shkoni në disa seminare etj. por ajo që është më me rëndësi është se ndoshta të gjitha nuk janë shpenzime reale që janë shpenzuar nga asambleja, por zakonisht në fund të vitit asambleja ka një teprice në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ne nuk guxojmë të lejojmë atë shumë që të na shkoj në suficite dhe e shpenzojmë në kategoritë e tjera, pra kjo është arsyeja. I nderuari z. Fehmi Cena është viti i dytë që në kuadër të buxhetit për Komunën e Rahovecit është e planifikuar edhe huamarrja, ne këtë të hyrë e marrim përmes Ministrisë së shëndetësisë, shuma për shëndetësi është diku 134,000.00 €, në vitin 2017 na i kanë lëshuar vetëm 7,000.00 €, kurse në vitin 2018 vetëm 18,000.00 €, pra kjo shumë është e cila ka ardhur në buxhetin tonë, kjo shumë është shpenzuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për Drejtorin e shëndetësisë.

Fehmi Cena – I nderuari drejtor në faqe nr.9 ceket buxheti i planifikuar, buxheti përfundimtar i shpenzuar, ju e ceket më parë buxhetin e shpenzuar në përqindje, i nderuar pjesa që nuk është shpenzuar ka shkuar në suficite, nëse është kështu dua ta di se cila është vlera që ka shkuar në suficit. Pastaj ne duhet të dimë se nga cila shtyllë e buxhetit që është paraqitur këtu mundemi me thënë se ka shkuar buxheti në suficit e parë apo e dyta.

Afrim Limani – I nderuar në shtyllën e parë e kemi buxhetin të alokuar sipas kategorive, kurse në shtyllën e dytë e kemi buxhetin të alokuar, pra buxheti i cili është ndarë në kuadër të komunës, pra Ministria e Financave

e ka alokuar atë pjesë, përqindja e shpenzimit të alokuar është 95,38%. Kurse i shpenzuar në raport me buxhetin e alokuar është 97,05 %.

Kryesuesi - JU faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë, faleminderit edhe drejtorit për sqarimet e dhëna. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Informatë nga Planit vjetor i njësisë së auditimit të brendshëm të KK- Rahovec.

Binak Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky plan është përpiluar në bazë të planit strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën auditimit të vitit 2019, ky plan përfshinë fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit. Ky plan duhet të shikohet gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës në mënyrë që të pasqyrojë ndryshimet e ndryshme të cilat do të ndodhin në komunën tonë, pastaj çdo ndryshim i planit vjetor do të aprovohet nga Kryetari i komunës. Në këtë plan përshihen aktivitetet e auditimit të njësisë së brendshme dhe arritja e objektivave strategjike, detyrat e auditimit, radhitja e detyrave të audituara në strategjinë e auditimit, prokurimi i burimeve dhe ndarja e detyrave të auditimit, rezultatet nga vlerësimi i rrezikut dhe koha efektive e punës e njësisë së auditimit të brendshëm. Detyrat e synuara të auditimit janë në drejtoritë e komunës së Rahovecit, në zyrën e personelit, në zyrën e prokurimit dhe sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës.

Rasim Fazliu – Falënderoj shefin e njësisë së auditimit të brendshëm që na ka sjellë këtë plan vjetor, mendoj se është një plan i mirë dhe gjithëpërfshirës. Duke e ditur rolin e auditimit të brendshëm i cili e ka rolin këshillues për Kryetarin e Komunës gjegjësisht ekzekutivin, do të ishte mirë që ky planifikim të reflektoj në kohë, vërejtjet sugjerimet të gjitha ato që duhet të i jepen me kohë kryetarit dhe drejtorive përkatëse, po ashtu edhe ne të njoftohemi me kohë rreth aktiviteteve që ka bërë auditori i brendshëm. Ne pak a shumë kemi një përvojë të keqe sepse raportet e auditimit të brendshëm ne si kuvendar i kërkojmë nga Kryetari i Komunës, pastaj kemi raste që nuk na kanë raportuar fare në vitet paraprake, ose nëse është raportuar është raportuar 2-3 vite me vonesë sa që më nuk ka pasur fare efekte ai raport. I nderuar z. Binak Kryeziu është mirë që të na jepe një përgjigje se kur do të na Raportoje për aktivitetet e zyrës së auditimit të brendshëm për vitin 2018, kurse për këtë planifikim na raporton në vitin 2020.

Binak Kryeziu – Sa i përket Planit vjetor shihet se veç janë paraparë aktivitetet e njësisë së auditimit të brendshëm, por të gjitha bëhen sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës ose drejtorisë përkatëse, nëse paraqesin ndonjë arsyeshmëri për auditim ad-hoc. Kurse sa i përket Raportit për vitin 2018, dua të ju them sa janë audituar 10 drejtori dhe njëra shtesë ka qenë sipas kërkesës së Kryetarit, nga të gjitha këto janë dhënë 53 rekomandime nga ana jonë, nga këto 32 rekomandime janë zbatuar, kurse 21 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve, kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Rekomandimeve për vitin 2018 nga auditori kombëtar (të jashtëm).

Afrim Limani – Të nderuar më duket se kjo pikë është për herë të parë në kuvend, është shumë mirë që ka ardhur në kuvend shpresoj se edhe herrave të tjera të vije rregullisht në kuvend sepse kjo i kontribuon shumë menaxhimit të qasjes së menaxhimit të parës publike. Ne si Drejtori e Financave e kemi përgatitë një plan të veprimit i cili ka dalë si rezultat i aplikimit të pasqyrave financiare për vitin 2017 nga ana e zyrës së auditorit kombëtar. Në këtë plan janë të përfshirë 13 rekomandime i cili ka dhënë auditori i jashtëm, deri në fazën e përpilimit të këtij plani ne vetëm 3 rekomandime i kemi plotësuar, kurse pjesa e mbetur është në proces, sipas mendimi time edhe pjesa dërmuese e këtyre janë kryer, përveç një ose dy raste që nuk vërret nga ne. Pe mare një shembull tek rekomandimi i parë ku ceket zyrtari financiar, në vitin 2017 ka qenë si e gjetur, besoj se edhe këtë vit do të jetë sepse aktualisht auditorët i kemi në komunë duke audituar dhe fjala e parë që më kanë pyetur është kush është zyrtari kryesor financiar, përgjigja ime ishte që ai zyrtar jam unë, realisht ko është një farë kundërshtimi në raport me ligjin, por historikisht Komuna e Rahovecit asnjë herë nuk e ka pasur këtë zyrtar. Por kjo nuk varret nga ne sepse MAPL-ja duhet të na krijojë edhe një vend të lirë të punës në Drejtorin e Financave në mënyrë që Komuna jonë të ketë edhe zyrtarin kryesor financiar.

Rasim Fazliu – Nuk e di ku është pengesa që të ketë komuna jonë një zyrtar kryesor financiar, përderisa kërkohet të jetë, nuk e di se ku qëndron pengesa a është se duhet të punësohet një njeri e nuk ka mjete buxhetore, apo nuk e lejon numri i punëtorëve. Sa i përket rekomandimeve kishte me qenë mirë që drejtorja përkatëse ose Kryetari i Komunës të i përfillë këto rekomandime në mënyrë që kur të në vije raporti i auditorit kombëtar të mos mëremi me këto vërejtjet.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar rreth pikë së shtatë, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2018.

Nenad Stashiq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe është themeluar me 30.07.2018. Nga themelimi e deri në dhjetor të vitit 2018 janë mbajtur 5 (pesë) mbledhje të cilat janë kryesuar nga kryetari i këshillit për fshatin Hoçë e Madhe. Në mbledhjen konstituive të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe ka marr pjesë kryesuesi i kuvendit të komunës së Rahovecit, Afrim Dina. Për kryetar të këshillit të fshatit për Hoçë të Madhe është zgjedhur Bojan Pavloviq. Në mbledhje, anëtarët janë njoftuar me Rregulloren e punës dhe udhëzimin administrativ për punën e këshillit. Janë vendosur qëllimet afatshkurtra dhe afatgjate të punës së këshillit për Hoçë të Madhe. Është aprovuar propozim buxheti për funksionimin e këshillit për Hoçë të Madhe. Për nënkryetar të këshillit për Hoçë të Madhe është zgjedhur Nenad Stashiq. Me kërkesë të inspektoratit të ndërtimtarisë, me paraqitjen e qytetarëve, këshilli ka formuar komisionin për vërtetimin e gjendjes faktike në lokacion – parcela nr. 02584/0. Është kërkuar plotësimi i dokumentacionit, lidhur me mundësin e dhënies së pëlqimit për ndërtimin e objektit. Është dhënë pëlqimi për ndërtimin e fushës sportive në shkollën “Svetozar Markoviq”. Projekti është financuar nga IOM-i dhe Komuna e Rahovecit, me kërkesë të komunitetit. Gjatë javëve të kaluara këshilli për Hoçë të Madhe ka shqyrtuar: Mbjelljen e pishave në vendin ku më parë janë hedhur mbeturina, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare. Shqyrtimi i mundësisë për përpilimin e planit rregullues (Master Planit) i cili është i nevojshëm për funksionimin e këshillit. Është marr iniciativa për renovimin e pjesës së ndërtesës së Shtëpi së Kulturës në Hoçë të Madhe. Është përgatitur projekti, ndërsa në takim me anëtarët e KFOR-it dhe CIMIC-ut, na është premtuar realizimi i këtij projekti.

Pastrimi i dopinisë së mbeturinave mbi ujëmbledhës në Hoçë të Madhe. Raporti financiar nuk është shqyrtuar sepse nuk është dërguar nga ana e Drejtorisë së Financave. Vërejtje: Për arsye administrative nuk është shfrytëzuar komplet buxheti i miratuar për punën e këshillit për Hoçë të Madhe. Mbi të gjitha faktet e përmendura, duke marr parasysh periudhën e shkurt kohore të themelimit të këshillit, mund të konstatojmë si një vit të suksesshëm. Me këtë rast duam t’ju falënderojmë të gjithë atyre të cilët ndihmuan në punën e këshillit, në veçanti kryesuesin e kuvendit, drejtorin komunale për urbanizëm, si dhe anëtarët e OSBE –së.

Fehmi Cena – Përshëndes nënkryetarin e Këshillit të Hoçës së Madhe Nenad Stashiq për këtë raport që na e prezantoi sot në kuvend, shumë mirë që paskan punuar diçka brenda këtij viti. Tek ajo që e cekë se nuk është prezantuar Raporti Financiar, sepse sipas tyre Drejtoria e Financave paska pas diçka me e rregullu, kisha kërkuar që në të ardhmen këtij raporti të i bashkëngjitet Raporti Financiar për të gjitha shpenzimet që i ka bërë ky këshill.

Rasim Fazliu – Po ashtu edhe unë e falënderoj nënkryetarin e këtij këshilli që na ka sjellë këtë raport,, por më shumë kisha me e quajtur informatë se sa raport sepse është shumë i shkurtër për tu quajtur raport. I bashka ngjitem kërkesës së parafolësit sa i përket raportit financiar, sepse duhet të jetë më gjithëpërfshirës ky raport të ketë më shumë të dhëna.


Kryesuesi – Ju faleminderit kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

9. Të ndryshme.

Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket pikës së fundit, mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 12:45


Procesmbajtësi,
Skender Hamza


KRYESUESI
Afrim Dina